



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.67, datë 30.07.2026

**“PËR MIRATIMIN E EMËRTIMEVE TË POZICIONEVE TË PUNËS TË STAFIT
TË QENDRËS SOCIALE DITORE, POLIVALENTE “MIDIS NESH”, BASHKIA
SKRAPAR.**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 30.07.2026, mori në shqyrtim projektaktin e mbështetur në pikën 2, të nenit 8, të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 1.1, të shkronjës “b”, të nenit 9, të nenit 24, të nenit 54, të pikave 3 dhe 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 121/2016, ‘Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë’, ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Skrapar “Për zbatimin e projektit ‘Qendra ditore Multifunksionale për grupet në nevojë’, VKB-së nr.48, datë 28.05.2026 “Për krijimin e Qendrës Sociale Ditore, “Midis Nesh”, Bashkia Skrapar,

VENDOSI:

1. Miratimin e emërtimeve të pozicioneve të punës të stafit të Qendrës Sociale Ditore, Polivalente “ Midis Nesh”, sipas aneksit bashkëlidhur.
2. Emërtimet e pozicioneve të punës të miratuara me këtë vendim do të përdoren për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Ditore, në përputhje me nevojat shërbimit të qendrës.

Vendimi u miratua me 8 Vota pro, vota kundër - s’ka , abstënim – s’ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Elsa PETRITAJ

